



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:243050

Datë: 11.01.2021

Numri i dokumentit: 01397342

P.nr. 1000/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P., gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu, në lëndën penale kundër të pandehurit F. Q. ngarruga “.....nr. 64, sipas aktakuzës së PPTH-së D.P. në Pejë PP/II .nr.1127/19 të dt.30.10.2019 për veprë penale : Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par 2 të KPK-së, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit F. Q. , mbrojtësit të tij av. Gëzim Baloku dhe të prokurorit të shtetit Sadije Muriqi me dt.28.12.2020 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri F. Q. i lindur me dt..... në , me vendbanim në Pejë rruga “.....”nr. 64, i biri i N. dhe nënës H. e gjinisë H., i njohur me dokument identifikues numër, ka kryer shkollën e mesme, me profesion automekanik , i martuar baba i 2 fëmijëve , i gjendjes së mesme ekonomike, kinse i pa dënuar më parë nga gjykata, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËAHTË FAJTORË :

Për shkak se :

Me parë e gjerë me dt. 21.2.2019 në kohë të panjohur , në Qendrën e qytetit të , në afërsi të QKMF-së përdorë dokumentin për të cilin e di se është i rremë dhe atë CRA-në me numër të lëshuar nga QKRA në si rezultat i veprës penale nga dispozitivi i parë, në atë mënyrë që , pasi i pandehuri F. kishte shfrytëzuar të drejtën invalidore të të pandehurit I. për regjistrimin e automjetit , ngjyrë e , me numër të falsifikuar të shashisë (origjinal) të pa zhdoganuar pronar i së cilës është F. Q. , me numër CRA –në në emër të Isa –së fillon të qarkulloj me automjetin e njëjtë , për çka me datën kritike (21.2.2019) ndalohet nga zyrtaret policorë të njësitit auto krimeve DRP-.... të cilëve u prezanton CVRA –në në fjalë, me ç’ rast i sekuestrohet vetura dhe dokumentet e regjistrimit .

me çka ka kryer veprë penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par 2 të KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 403 par 2 të KPRK-së. I SHQIPTON.

DËNIM TË KUSHTËZUAR

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 10 muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale .

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej nga 15 euro , në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 30 euro dhe në emër të taksës për mbrojtjen e

viktimave të krimit shumë prej 30 euro - të gjitha këto 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Certifikata e regjistrimit të automjetit me numër CRA –**KONFISKOHET**,

Automjeti i makrës “.....” me targa, me nunër të karrocërisë dhe çelësi i të njëjtit **IKTHEHEN** pronarit- kompanisë së sigurimeve “.....” nga R. e apo të autorizuarit të saj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.30.10.2019 kundër të pandehurve I. B. dhe F. Q., ka ngritë aktakuzë me numër PP/II . nr.1127/19, për vepër penale të kryer secili veç e veç : Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par 1 dhe neni 403 par 2 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurit ti shpallë fajtorë , ti dënoj sipas ligjit dhe ti obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Për dt.28.12.2020, gjykata e ka caktuar shqyrtimin gjyqësorë në të cilin janë paraqitur prokurori i shtetit Sadije Muriqi i pandehuri F. Q. dhe mbrojtësi i tij av. Gëzim Baloku ngai caktuar sipas autorizimit, nuk ka ardhur i pandehuri I. B., edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt kurse mos ardhjen nuk e ka arsyetuar , për çka gjykata për shkak të ekonomizimit të procedurës e ka bërë veçimin e lëndës, duke mbajtur shqyrtimin gjyqësor për të pandehurin F. Q. dhe duke urdhëruar që për të pandehurin I. B. të formohet lëndë me numër të ri.

Në shqyrtimin gjyqësorë i pandehuri F. Q. – pasi që paraprakisht i është lexuar akuza, është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit së shtetit dhe mbrojtësit të tij , e ka pranuar , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë!.

Në fjalën përfundimtare palët kanë deklaruar :

Prokurori i shtetit :

“Meqenëse i pandehuri bëri pranimin e fajësisë i cili pranim mbështet edhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të cilat flasin për fajësinë e tij , i propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtorë të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagimin e shpenzimeve procedurale, po ashtu i propozoj gjykatës që konform neni 267 ti shqiptoj dënimin plotësues dhe atë të bëhet konfiskimi i automjetit sikur në dispozitivin e aktakuzës”.

Mbrojtësi i të pandehurit F. Q. av. Gëzim Baloku :

“Meqenëse i mbrojturi im e pranoj fajësinë atëherë nuk mbetet tjetër që gjykatës ti propozoj që gjatë vendosjes mbi vendimin mbi dënim gjykata ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese siç jam pranimi i fajësisë, padenueshmeria e mëparshme , sjellja korrekte ndaj gjykatës si dhe respektimin i gjykatës në të gjitha fazat . Duke i marrë parasysh këto rrethana mendoj se edhe me një dënim me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat ligjore – ngase i pandehuri ka qenë në lajthim në momentin kur e ka blerë automjetin dhe nuk e ka ditur se i njëjti është i falsifikuar dhe si të tillë e ka përdorur. Sa i përket automjetit në fjalë meqenëse është automjeti i vjedhur i njëjti duhet ti kthehet pronarit të tij e pronarë është kompania e sigurimit “.....”-.....”

I pandehuri:

“Në tërësi e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim”.

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese, me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur, kurse nga ato lehtësuese ka çmuar: pranimin e sinqertë të fajësisë, që është rrethanë veçanërisht lehtësuese, pendimin e thellë për këtë, qëndrimin korrekt në gjykatë, padënueshmërinë e mëparshme dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së.

Duke vendosur përkitazi me propozimin e prokurorit për konfiskimin e automjetit, çelësit të tij dhe certifikatës së regjistrimit të automjetit në fjalë, dhe kërkesës të mbrojtësit të të pandehurit për kthimin e automjetit - e pas elaborimit deri në detale të shkresave të lëndës gjyqtari ka gjetur se:

Certifikata e regjistrimit të automjetit me numër CRA duhet konfiskuar dhe atë konform neni 69 par 1 të KPK-së –ngase e njëjta është rezultat i kryerjes së veprës penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor, ndërkohë që përkitazi me propozimin për konfiskimin e automjetit të markës “.....” me targa, me nuni të karrocërisë si dhe çelësit të tij gjyqtari ka ardh në përfundim se:

Automjeti në fjalë dhe çelësi i tij nuk janë pronë e të pandehurit dhe se i njëjti automjet është i vjedhur dhe i përket palës së tretë – në këtë rast kompanisë së sigurimeve “.....” nga R. e- për çka është vendosur që automjeti bashkë me çelësin pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ti kthehen pronarit - përkatësisht të autorizuarit të tij. Kësaj është vendosur edhe duke u bazuar në neni 69 par 2 të KPK-së ku decidivisht thuhet: “ sendet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të konfiskohen edhe kur nuk janë pronë e kryesit ... nëse kjo nuk ndikon dëmshëm mbi të drejtat e palës së tretë për të marrë nga kryesi kompensimin e çfarëdo dëmi”. Dhe, meqenëse automjeti në fjalë është pikërisht pronë e palës së tretë –palës së dëmtuar e cila nuk bart kurrfarë përgjegjësie për veprën e kryer nga dikush tjetër - në mënyrë që kjo palë të mos dëmtohet edhe është vendosur që automjeti pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit ti kthehet pronarit, përkatësisht të autorizuarit të tij.

Ndryshe, neni 403, nuk parasheh fare marrjen (konfiskimin) e sendit – paçka neni 69 par 3 thotë: “ me ligj mund të përcaktohet marrja e detyrueshme e sendit”!

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform neni 450 të KPPRK-së .

Vendimi mbi obligimin e të pandehurit për pagesën e taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit është marrë konform Ligjit nr. 05/L-036.

Vendimi mbi konfiskimin e certifikatës së regjistrimit të automjetit është marrë konform neni par 69 par 1 të KPK-së

Vendimi mbi kthimin e sendit -veturës dhe çelësit është marrë konform neni 116 par 1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë konform neni 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.28.12.2020.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes, Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .